



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANE GJKATES SE APELIT KORÇË

R A P O R T
MBI VEPRIMTARINE E PROKURORISE SE APELIT KORÇE
PER PERIUDHEN 1 JANAR 2016 -DHJETOR 2016

Z.ADRIATIK LLALLA
PROKUROR I PERGJITHSHEM I REPUBLIKES

PROKURORIA E PERGJITHSHME
T I R A N E

Viti 2016 , ka qene viti kur reforma “Per drejtesine” ka qene refren i dites e materializuar ne ndryshime te medha ligjore.Tashme ne jemi ne kete proces te rendesishem dhe jetik per drejtesine shqiptare por ne vemendjen e prokurorive ka qene ustrimi i fuknsionit ne perputhje me Kushtetuten dhe ligjin procedural penal dhe ate material.

Në fokus te veprimtarise dhe punes se prokurorise ka qene ndeshkimi i korrupsionit dhe fenomeneve te tjera shqetsuese per shoqerine shqiptare,si fenomene që mbajnë peng zhvillimin e vendit dhe shoqerise, si dhe bëhen pengese për procesin integrues të Shqiperie ne Bashkimin Evropian. Në funksion të këtij qëllimi madhor, kemi synuar ne menyre te vazhdueshme rritjen e standarteve te gjykimit me nje perfaqesim cilesor te prokurorit, duke mbajtur parasysh rekomandimet e Keshillit te Ministrave ne luften kunder kriminalitetit, Udhezimet e Prokurorit te Pergjithshem.

Ne kete konteks,Prokuroria e Apelit Korçe, ka qene ne koherence te plote te kerkesave te kohes dhe kjo materializohet me se miri ne qendrimet qe ka mbajtur.

Ne analizen qe do te bej me poshte do te perqendrohem ne probleme te rendesishme qe lidhen jo vetem me qendrimin e prokurorit te apelit ne raport me kerkimet e bera nga prokuroret e shkalles se pare dhe qendrimin e gjykates, por edhe probleme te hetimit dhe gjykimit qe duhet te behen evidente me qellim qe te riparohen.

Ne vazhdim te ketij raportimi fillimisht do te japim nje paraqitje me shifra te volumit te çeshtjeve te perfaqesuara nga Prokuroria e Apelit

Korçe per vitin 2016 dhe me pas disa probleme qe kane dale gjate gjykimit te çeshtjeve te ndryshme.

Keshtu volumi i çeshtjeve te ndjekura nga Prokuroria e Apelit Korçe eshte si me poshte :

Jane regjistruar gjithesej 579 çeshtje nga te cilat 559 çeshtje te reja dhe 20 çeshtje te mbartura nga viti 2015.

Ne Gjykatën e Apelit Korçe per vitin 2016 jane perfunduar 268 çeshtje themeli, 76 çeshtje te veçanta dhe 216 masa sigurimi ndersa jane mbartur 15 çeshtje per vitin 2017.

Nga numuri i pergjithshem i çeshtjeve te themelit vetem 14 raste kane qene kundervajtje penale qe jane shqyrtuar mbi apelin e te pandehurit ose te demtuarit akuzes apo te akuzuarit.

Çeshtjet e themelit jane shqyrtuar 47 raste mbi apelin e prokurorit dhe 221 çeshtje raste mbi apelin e te pandehurit.

Te ndara sipas prokurorive qe jane ne juridiksionin e Prokurorise se Apelit Korçe:

Per Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Korçe jane shqyrtuar 209 çeshtje, nga te cilat 37 çeshtje mbi apelin e prokurorit dhe 172 raste mbi apelin e te pandehurit

Per Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Pogradec jane shqyrtuar 59 çeshtje nga te cilat 10 raste mbi apelin e prokurorit dhe 49 raste mbi apelin e te pandehurit.

Ne te dhenat statistikore nuk perfshihen 78 çeshtje te perfunduara te cilat ne i kategorizojme te veçanta pasi kjo kategori nuk eshte e parashikuar.

Ne Prokurorine e Apelit ushtrojne funksionin dy prokurore ngarkesa e çeshtjeve per secilen prokurore eshte si me poshte:

Prokurore Irma Balli me cilesine e Drejtuesit te Prokurorise se Apelit ka perfaqesuar:

131 çeshtje themeli.

85 masa sigurimi.

30 çeshtje te tjera te kategorizuara te veçanta.

Ka ushtruar 30 rekurse.

Ka urdheruar 28 ekzekutime vendimi.

Po keshtu ka ndjekur veprimtarine e prokurorise me cilesine e drejtueses bazuar ne ligjin “Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise”.

Prokurore Rozeta Qirjaqi ka perfaqesuar:

137 çeshtje themeli.

131 masa sigurimi.

40 çeshtje te veçanta.

Ka ushtruar 50 rekurse.

Ka urdheruar 39 ekzekutime vendimi.

Duke krahasuar numurin e pergjithshem te çeshtjeve te rregjistruara ne vitin 2016 me çeshtjet e regjistruara per vitin 2015 rezulton se ka nje ulje prej 69 çeshtjesh (ka qene 648 numuri i pergjithshem i çeshtjeve vitin e kaluar).

Me poshte po japim nje pasqyre me te hollesishme te shqyrtimit te çeshtjeve ne Gjykatën e Apelit, shkaqet e apelimeve te bera, perkrahjes se tyre dhe menyres se perfundimit ne Gjykatën e Apelit.

Per çeshtjet e kategorizuara te veçanta rezulton se :

Jane perfunduar 78 çeshtje te kategorizuara te veçanta ku perfshihen çeshtje penale me objekt vendim pushimi, mosfillimi, lirim me kusht, çeshtje qe lidhen me fazën e ekzekutimit te vendimit etj.

Ne keto lloj gjykimesh sidomos ne ato çeshtje qe lidhen me vendimet e pushimit dhe te mosfillimit Prokuroria e Apelit eshte udhehequr nga parimi : *Qe çeshtja duhet te hetohet ne teresi, hetimi si detyrim Kushtetues i Prokurorisë duhet te jete i plote dhe vendimmarrja te jete sa me objektive duke pasur parasysh qe shpesh vendimi i pushimit prek interesa te kerkuesve si dhe mosfillimi te vendoset kur jane te pranishme kerkesat e nenit 290 K.Pr.Penale.*

Ne kujdes kane qene sidomos çeshtjet me pasoje vdekje te personit nga aksidentet me qellim qe vendimmarrja te jete objektive dhe çdo pale te jete e qarte per kete zgjidhje.

Eshte konstatuar here pas here qe vendoset mosfillimi mbi akte te cilat te japin njoftimin se ka filluar ne fakt çeshtja penale dhe vendoset mosfillim duke vleresuar provat. Kam mendimin qe vendimi i mosfillimit nuk lidhet me hetim paraprak, por mbi nje material nga i cili ne menyre te sakte dhe qarte percakton se jane kushtet e nenit 290 K.Pr.Penale.

Çeshtjet qe lidhen me te demtuarin akuzues, procesi eshte orientuar sipas nenit 59 K.Pr.Penale dhe prokurori ka ushtruar funksionin brenda kufijve te parashikuara nga kjo dispozite, por gjithmone me nje rol aktiv per te dhene mendim , lidhur me fajesine e te akuzuarit, ne vleresimin e provave te paraqitura nga palet ne proces, apo dhe ne dhenien e mendimit per masen e denimit.

Problematike eshte konstatuar gjate gjykimit te çeshtjeve ne fazën e ekzekutimit.

Problemi ka lindur lidhur me zbatimin e “Ligjit per dhenie amnistie” nr. 154/2015 te vitit 2015, sidomos me piken c te nenit 3 dhe nenin 4 te ketij ligji. Qendrimet kane qene te ndryshme. Por mendimi i prokurorit ne te dy shkallet e gjykimit, eshte orientuar nga mendimi i Prokurorisë se

Pergjithshme bazuar ne shkresen nr.343/1 dt 03.04.2016. Nga Gjykata ne keto raste nuk jemi mbesheshtetur dhe te gjitha çeshtjet jane ankimuar me rekurs ne Gjykatën e Lartë. Rezulton se nuk eshte dhene vendim lidhur me kete çeshtje.

Debat ka pasur me zbatimin e kerkesave te nenit 471 K.Pr.Penale me objekt, "Lirim me kusht" sipas nenit 64 K.Penal. Eshte konstatuar, se kerkesa nga i denuari eshte paraqitur ne Gjykata pa plotesuar kriterin formal te mases se denimit te kryer sipas nenit 64 K.Penal.

Konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor, vihet ne dijeni te faktit se mungon kriteri perjashtues, por shtyn seancën deri ne datën kur kerkuesi ploteson denimin si kriter i kerkuar nga neni 64 K.Penal dhe merr ne vleresim me pas kerkesat e tjera.

Çeshtjet qe lidhen me kerkesat ne fazën e ekzekutimit te vendimeve penale parashikohen ne Titullin IX Kreu II te K.Pr.Penale.

Duke iu referuar nenit 471/2 K.Pr.Penale te ketij kreu, gjykata ka detyrimin qe te verifikoje nese ishte e bazuar kerkesa apo jo.

Qe ne kete moment kjo gjykate duhet te rrezonte kerkesën si te pabazuar dhe brenda 5 diteve te njoftoheshin palet per te ushtruar ankim

Edhe keto raste jane bere objekt i ankimit me rekurs ne Gjykatën e Lartë.

Per çeshtjet e themelit japim kete pasqyre:

Ne 68 çeshtje per te cilat eshte kerkuar mospranim ankimi, nga gjykata eshte vendosur me 68 vendime mospranim ankimi.

Ne 141 raste per te cilat eshte kerkuar nga prokurori i apelit lenie ne fuqi te vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare, nga gjykata ne 101 vendime eshte vendosur: lenie ne fuqi, ne 35 raste eshte lehtesuar pozita, dhe ne 5 raste eshte pushuar çeshtja apo eshte dhene pajafsi.

Ne 29 raste kur eshte kerkuar rendimi i pozites te te pandehurit, gjykata ne 26 raste ka vendosur lenie ne fuqi te vendimit, ne 1 rast ka renduar poziten me vendim fajesie ndersa ne 1 rast gjykata ka lehtesuar poziten e te pandehurit (perveç apelit te prokurorit ka pasur edhe apel te te pandehurit) dhe ne 1 rast eshte vendosur prishje e vendimit dhe kthimi i çeshtjes per rigjykim.

Ne 24 raste nga prokurori i apelit eshte kerkuar lehtesim i pozites te te pandehurit nga ana e prokurorit dhe nga Gjykata e Apelit ne 23 raste eshte lehtesuar pozita e te pandehurit ndersa ne 1 rast eshte lene ne fuqi çeshtja (prokuroria ka kerkuar gjobe gjykata ka vendosur pezullimin e denimit me burgim).

Ne 1 rast eshte kerkuar prishje dhe pushim çeshtje dhe ne 1 rast gjykata ka vendosur prishje vendimi dhe pushim i çeshtjes.

Ne 6 raste eshte kerkuar prishje vendimi dhe kthimi i çeshtjes per rigjykim, nga gjykata ne 4 vendime eshte vendosur lenie ne fuqi te

vendimit, ne 2 raste eshte vendosur prishje vendimi dhe kthimi i çeshtjes per rigjykim.

Lidhur me apelet e ushtruara nga Prokuroria e Shkalles se Pare:

Konstatohet ulje te ndjeshme te numurit te apelimeve te bera nga prokuroret duke e krahasuar me vitin e kaluar. Per kete vit jane ushtruar gjithesej 47 apele nga 104 te ushtruara vitin e kaluar. Nga keto 24 jane ushtruar per mase te bute denimi kryesisht per aplikimin e nenit 59 K.Penal, 16 per pafajsi te dhene nga gjykata dhe 7 apele per ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale.

Apele te ushtruara nga prokuroria per vendime pafajsie:

Jane ushtruar 16 Apele per vendim pafajsie nga Prokurorite e Rrethit Gjyqesor per te cilat:

Per 5 raste jane autorizuar prokuroret e çeshtjes pasi Prokuroria e Apelit nuk ka qene dakort dhe ka pasur mendim te ndryshem nga çfare eshte parashtruar ne apel. Autorizimi eshte bere pasi eshte respektuar procedura e kerkuar nga Udhezimi i Prokurorit te Pergjithshem dhe Kodi i Procedures Penale. Konstatohet se ne keto rastet nuk eshte pranuar kerkimi i bere nga prokurori i çeshtjes (i autorizuar) nga ana e Gjykates se Apelit.

Ne 2 raste hequr dore nga apeli i prokurorit dhe i perket çeshtjes penale me te pandehur Dhimiter Pallani akuzuar per vepren penale te “ Braktisjes se femijeve”, parashikuar nga nenin 124 K.Penal dhe çeshtjes penale me te pandehur Agim Pili i akuzuar per vepren penale te “Largimit nga vendi i aksidentit” parashikuar nga neni 273 K.Penal. Per kete qendrim eshte diskutuar me Prokurorine e Shkalles Pare dhe eshte informuar Prokuroria e Pergjithshme dhe me pas eshte vendosur pasi eshte konkluduar per kete qendrim.

Ne 1 rast ka ndryshuar vendimi me deklarim fajesie te te pandehurve sipas kerkimit te Prokurorit te Apelit.

Ne 2 raste eshte prishur vendimi dhe eshte vendosur prishje vendimi dhe kthim per rigjykim.

Per te gjitha rastet e tjera qe nuk jane pranuar nga gjykata dhe kane qene shkaqet ligjore te parashikuara nga neni 432 K.Pr.Penale, eshte ushtruar rekurs per te cilat nuk kemi marre pergjigje.

Apel te ushtruara nga prokuroria per vendime me ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale.

Jane ushtruar 7 apele per ndryshim te kualifikimit ligjor te vepres penale nga te cilat.

Ne 2 raste jane autorizuar prokuroret e Prokurorise se Shkalles Pare pasi Prokuroria e Apelit nuk ka qene dakort dhe ka pasur mendim te ndryshem nga çfare eshte parashtruar ne apel. Autorizimi eshte bere pasi eshte respektuar procedura e kerkuar nga Udhezimi i Prokurorit te Pergjithshem dhe Kodi i Procedures Penale. Konstatohet se ne keto rastet nuk eshte pranuar kerkimi i bere nga prokurori i çeshtjes (i autorizuar) nga ana e Gjykates se Apelit.

Ne 1 rast vendimi i prishur dhe çeshtja eshte kthyer per rigjykim sipas kerkimit te bere nga ana e Prokurorit te Apelit.

Ne rastet e tjera, eshte lene ne fuqi vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor dhe Gjykates se Apelit.

Apele te ushtruara nga prokuroria per vendime me mase denimi te bute.

Ne pergjithesi apelet me kete objekt jane ushtruar per te ndryshuar alternativen e pezullimit te denimit me burgim dhe masen e denimit qe ka qene relativisht e ulet. Ne pergjithesi, ato kane qene te lidhura me kryerjen e vepres penale te parashikuar nga neni 291, nenin 273 K.Penal te ndryshuar dhe prokuroria e ka mbeshetur denimin me burgim per te qene koherente me politiken e ashper te denimit qe orientohet ne keto raste.

Te njejten qendrim ka mbajtur edhe per dhunen ne familje neni 130/a K.Penal apo ndertimet pa leje 199 K.Penal.

Jane ushtruar 24 apele per te ndryshuar masen e denimit, shumica per te mos thene gjithe rastet jane te lidhur me alternativat denimit.

Ne 3 raste jane autorizuar prokuroret e çeshtjes qe kane ushtruar apel duke qene se mendimi i Prokurorit te Apelit ka qene i ndryshem. Ne te gjitha rastet nuk ka ndryshuar vendimi i apeluar.

Ne 8 raste eshte hequr dore nga apeli i prokurorit perfshi edhe prokurorin e çeshtjes i cili ka qene i autorizuar veprim, per te cilen eshte respektuar kuadri ligjor, marredhenia me Prokurorine e Shkalles Pare dhe Drejtorine e Gjyqesorit prane Prokurorise se Pergjithshme.

Ne 1 rast eshte ndryshuar vendimi duke u ashpersuar masa e denimit.

Ne te gjitha rastet e tjera eshte lene ne fuqi vendimi. Kur kane qene kushtet eshte ushtruar rekurs ne Gjykatën e Larte.

Lehtesim i pozites se te pandehurit vendosur nga gjykata:

Ne 58 çeshtje te apeluara nga te pandehurit Gjykata ka vendosur lehtesim te pozites se tij me zbutje denimi apo deklarim te pafajshem.

Ne rast se shihet pasqyra e çeshtjeve (sipas pasqyrave te statistikes), per kete ndryshim zbutja e denimit lidhet me kryerjen e vepres penale te drejtimit te automjetit ne menyre te parregullt, ndertim i paligjshem,

vjedhje e energjise dhe dhune ne familje dhe eshte vendosur aplikimi i nenit 59 te K.Penal.

Ne 5 raste nga gjykata eshte dhene pafajsi ose pushuar çeshtja .

Nga Prokuroria e Apelit eshte ushtruar rekurs ne te gjitha rastet kur eshte vleresuar zbatim i keq i ligjit material apo procedural nga ana e Gjykates.

Nga 58 rastet ne 23 raste prokurori ka qene per zbutje te denimit qe lidhen me vepra te lehta dhe kur kane qene kushte per aplikimin e nenit 59 te K.Penal apo nenit 63 te K.Penal.

Ne 23 raste (çeshtjet te shqyrtuara mbi apelin e te pandehurit) nga prokurori i apelit,per shkelje te ligjit procedural penal, me pasoje pavlefshmeri vendimi apo mosarsyetim vendimi nga Gjykatat e Rrethit Gjyqesor ,eshte kerkuar prishje vendimi e kthim çeshtjeje per rigjykim. Ne pergjithesi, ato lidhen me çeshtje te shqyrtuara ne Gjykatën e Apelit mbi apelin e prokurorit.

Gjate shqyrtimit te çeshtjeve te themelit Prokuroria e Apelit ka pasur piksynim paraqitjen me cilesi te konkluzioneve si ne rastet kur eshte kerkuar lenie ne fuqi te vendimit por sidomos ne çeshtjet ku eshte dhene pafajsi dhe eshte argumentuar e kunderta apo edhe ne rastet kur eshte kerkuar ndryshim i kualifikimit ligjor. Konkluzioni eshte se ne pergjithesi apelet e ushtruara nga Prokurorite e Shkalles se Pare kane qene ligjore dhe jane mbeshtetur nga ana jone por ka vend per te ndryshuar. Shpesh here apelet jane bere objekt i diskutimit me prokuroret per menyren e formulimit problemin e ushtruar per zgjidhje apo te plotesuar ate sipas nenit 415 te K.Pr.Penale veprim i cili rralle ndodh.

Bazuar ne rekomandimet e Keshilit te Ministrave dhe udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem konstatohet kerkesa te pakta te prokurorise per gjykime te drejtperdrejta sidomos per çeshtjet qe hetimi perfundon brenda kohes se “arrestit ne flagrance” dhe lidhet me çeshtje fakti.

Çeshtjet me te arrestuar ne pergjithesi jane hetuar dhe gjykuar ne kohe por konstatohen edhe zgjatje afati pa ndonje arsye te thelle ligjore. Problem kane qene çeshtjet qe lidhen me kryerjen e akteve te ekspertimit te drogave te ndryshme por edhe raste te tjera.

Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar, prandaj për të patur sukses në luftën kundër kriminalitetit është e nevojshme të kryhen hetime të shpejta dhe efikase por edhe nje gjykim brenda nje afati sa me te shkurter dhe arsyeshem.Ne respektim te ketij parimi,Prokuroret e Apelit kane respektuar afatet ligjore te gjykimit te çeshtjes duke mos u bere pengese ne asnje rast, per shtyrjen e gjykimit te çeshtjes ne Gjykatën e Apelit .

Apelet e ushtruara nga ana e prokurorise per masen e denimit dhe qe lidhen me vepra te renda veprat penale te, korrupsionit, pastrimit të parave, krimit ekonomik e financiar,te prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake,veprat penale kundër mjedisit dhe ndërtimit të

paligjshëm kanë qene të pabazuara dhe janë mbeshtetur nga prokuroria por një pjesë e apeleve e sidomos për aplikimin e alternativave të denimit me burgim janë të tepruara megjithatë janë mbeshtetur edhe nga prokuroret e apelit. Por tashmë mesazhi që ka ardhur nga gjykata është se personat që kryejnë vepra të lehta për herë të parë, janë të parrezikshëm që janë deklaruar fajtorë ndaj tyre janë aplikuar alternativa të denimit siç janë vënia në provë nën 59 i K.Penal apo puna në interes publik nën 63 K.Penal. Në këtë pikë të analizës kemi vend për të reflektuar. Aplikimi i alternativave të denimit duhet parë me përparësi kur janë kushtet. Kjo vjen edhe si kërkesë e kohës e Rekomandimeve të Keshillit të Ministrave që orienton se: *Zbatimi i masave alternative të dënimit, ndaj personave me rrezikshmëri të ulët shoqërore, që kryejnë vepra penale me masë dënimi në maksimum deri 5 vjet burgim, por edhe e standarteve të referuara. Me këtë rast citoj: Sipas standarteve ndërkombëtare përdorimi i burgimit si formë dënimi duhet kufizuar rreptesisht dhe të jetë extrema ratio, në rastet e veçanta atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të pershtatshme. Siç shprehet Keshilli i Evropës burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papershtatshme për rëndësinë e veprës dhe duhet të behen përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që privojnë personin nga liria dhe të zbatohen me shumë ato të cilat nuk e bëjnë këtë.*

Ketu shtoj faktin se aplikimi i alternativave të denimit është bërë pjesë diskutimeve edhe në tryeza të vazhdueshme të organizuar nga Ministria e Drejtësisë me praninë e asistencës ndërkombëtare. Mesazhi që vjen është: Aplikimi i alternativave të denimit, kur burgimi është mjet i papershtatshëm në raport me rëndësinë e faktit dhe rrezikshmërinë e autorit.

Nga analiza e rasteve të gjykuara në Gjykatën e Apelit për vitin 2016 mendoj se është bërë profilaksi nga dënimet e aplikuar. Ka rënie të numrit të çështjeve që lidhen me drejtimin e automjeteve në gjendje të parregullt, aksidentet rrugore, ndertimet e paligjshëm apo dhunës në familje.

Çështjet me objekt caktim masë sigurimi.

Viti që analizohet ka pasur një rritje të shqyrtimit të masave të sigurimit. Këto vitet janë rregjistruar 218 masa sigurimi, nga 149 që janë rregjistruar vitin e kaluar.

Jane shqyrtuar dhe perfunduar gjithsej 216 ndërsa 2 çështje janë mbartuar për vitin 2017.

Masat e sigurimi në 35 raste janë shqyrtuar mbi apelin e prokurorit dhe në 181 raste mbi apelin e shtetasit nën masë sigurimi.

Ne 31 raste eshte kerkuar nga prokurori i apelit per ndryshim te mases se sigurimit nga te cilat 20 raste per mase me te rende sigurimi “ arrest ne burg” dhe 11 raste per mase me te bute sigurimi. Ne 6 raste jane pranuar nga Gjykata e Apelit duke vendosur masa e “arrestit ne burg”, ne 8 raste eshte pranuar kerkimi i prokurorit duke u vendosur mase me te bute sigurimi, ndersa 16 raste nuk eshte pranuar kerkesa e prokurorit nga Gjykata e Apelit Korçe duke u miratuar vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor dhe ne 1 rast eshte vendosur shfuqizimi i vendimit te mases se sigurimit. Ne 166 raste eshte kerkuar miratim vendimi te mases se sigurimit te vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korçe ne 121 raste eshte miratuar vendimi nga Gjykata e Apelit , ne 41 raste eshte ndryshuar masa e sigurimit “Arrest ne burg”ne nje mase sigurimi me te bute ndersa ne 4 raste eshte shfuqizuar vendimi.

Ne gjykimet me kete objekt, Prokuroria e Apelit orientohet ne zbatimin me korrektesi jo vetem te nenit 228 e 229 te K.Pr.Penal por sidomos te kerkesave te nenit 230 te K.Pr.Penale lidhur me kriteret e veçanta te “arrestit ne burg”.Megjithate duhet te tregohet kujdes ne aplikimin e kesaj mase sigurimi. Duhet te aplikohet masa e sigurimit garanci pasurore e cila mund te them qe eshte e rralle.Si rekomandon Keshilli i Ministrave, *kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo kërkohet/vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme;*

Ashpërsim të masës së sigurimit/dënimit ndaj personave me rrezikshmëri të madhe shoqërore, dhe për vepra penale që parashikojnë masë dënimi në minimum mbi 5 vjet burgim;

Ajo qe dua te evidentoj se ka ndryshuar fenomenin e “arrestit ne shtepi” e spikatur vitin e kaluar. Por ka qene qendrimi i Gjykates se Apelit mbi kerkimin tone qe ka ndryshuar kete rit.

Mendoj qe ne kerkimet per masen e sigurimit “arrest ne burg” Prokuroria duhet te jete e kujdesshme sepse kjo mase nuk mund te behet pafund prioritare ne raport me masat e tjera sigurimit edhe per vepra te lehta.Pavaresisht se veprat penale e parashikuar nga neni 291, 199/a apo neni 137 K.Penal kane qene ne vemendje te shtetit shqiptar nuk do te thote qe” arresti ne burg” te kerkohet pa kriter edhe kur mungojne kerkesat e nenit 230 K.Pr.Penale, aq me teper qe jane vepra penale qe ne maksimum kane denim me 5 vjet dhe nuk vleresohet veper penale veçanerisht e rrezikshme. Aplikimi e garancise pasurore eshte minimal ne nje kohe qe efikasiteti eshte me i madh.

Edhe kete vit konstatohen kerkesa per “ arrest ne burg me afat”, kerkese qe vjen ne kundërshtim me parashikimin e nenit 245 K.Pr.Penale. Shpesh, ajo vendoset ne sherbim te dyshimit te arsyeshem duke shkelur kerkesat e nenit 228 K.Pr.Penale dhe gjate gjykimit ne Gjykatën e Apelit kane pasoje zhvlefesim mase sigurimi.

Nga Prokurori i Apelit kane dale 77 Urdhera ekzekutimi te vendimeve penale te urdheruara menjehere nga Gjykata e Apelit.

Nga Prokurori i Apelit jane ushtruar 81 rekurse qe lidhen me pafajesi, ndryshim kualifikimi , mase denimi apo masa sigurimi.

Nga ana e prokurorise per natyren e veprimtarise se saj ,ka nje bashkepunim mjaft te mire korrekt me Prokurorite Rrethit Gjyqesor dhe policine gjyqesore prane saj. Ky bashkepunim eshte i domosdoshem per nje zgjidhje te drejte dhe ligjore gjate gjykimit te ceshtjes ne Gjykatën e Apelit.Kjo kushtezon nje komunikim permanent ne marrjen e akteve te ndryshme, fashikullit te prokurorit, marrjen e provave shtese kur çelet shqyrtimi gjyqesor apo edhe per fazen e ekzekutimit.

Ne çdo moment nga prokuroria e Apelit, ve ne dijeni Prokurorine e Rrethit (drejtuesin apo dhe prokurorin e ceshtjes) per perfundimin e ceshtjeve, sidomos ato te ndjekura mbi apelin e prokurorit.

Mbarevajtja e veprimtarise se Prokurorise se Apelit, lidhet edhe me nje bashkepunim te mire me Gjykatën e Apelit, sidomos per momentin e marrjes se dosjes per studim apo venies ne dispozicion te shkurtimit te vendimit per momentin e ekzekutimit te menjehershem prokuroreve.

Prokurori i Apelit eshte model ne marredhenien me Gjykatën e Apelit sepse respekton ne maksimum solemnitetin dhe ecurine e ceshtjes ne kohe rekord duke mos u bere asnjehere pengese per shtyrjen e gjykimeve. Konstatohet nje marredhenie korrekte me Drejtorine e Gjyqesorit ne sherbim te nje perfundimi sa me cilesor te ceshtjes.

Ne Prokurorine e Apelit Korçe gjatë vitit 2016 janë përmbushur të gjitha shpenzimet e parapara në projektbuxhetin e vitit 2016 qe perfshijne zerat paga, sigurime shoqerore dhe shpenzimet operative.

Korrektesia dhe disiplina financiare kanë qënë në nivel shume te larte ne menyren e administrimit sa më eficient të shpenzimeve.

Konstatohet bashkepunim efektiv me Drejtorine Ekonomike prane Prokurorise se Prokurorise se Pergjithshme.

Disiplina ne pune shihet si nje element qe ndikon ne veprimtarine e Prokurorise se Apelit e cila respektohet nga te gjithe punonjesit.

Po keshtu Kodi Etikes dhe rregullat e vendosura prej tij jane ne vemendje te prokuroreve dhe punonjese te tjere te Prokurorise dhe respektohen maksimalisht.

Faleminderit!

PROKURORE E APELIT
Irma BALLI